

3753/1
nr. 11-2019.

- D. F. Ekonom
- 2v. Referat
O. Zekaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE DHE PËRPUTHSHMËRISË PËR
ARSIMIN, SPORTIN DHE RININË
DREJTORIA E DERREGULLIMIT, LEJEVE, LICENCAVE DHE MONITORIMIT

Nr. 9885/1 Prot.

Tiranë, më 14.11. 2019

Lënda: Kthim përgjigje

UNIVERSITETIT "LUIGJ GURAKUQI", SHKODËR

Shkodër

Në përgjigje të shkresës suaj Nr.3753 prot, datë 31.10.2019, regjistruar me Nr.9885 prot, datë 4.11.2019 të MASR, kërkesë për mbështetje në organizimin e programit të ciklit të tretë të studimit, doktoratë në "Ekonomi dhe Turizëm të Qëndrueshëm" në kuadër të partneritetit në projektin e Bashkimit Europian "MARDS- Reformimi i studimeve doktrale në Mal të Zi dhe Shqipëri - paradigma e praktikës së mirë", ju bëjmë me dije se:

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë trajton çdo aplikim për hapje programi të studimit, që plotëson standardet, kriteret dhe dokumentacionin që parashikohet në ligjin nr.80/2015 dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

MASR me shkresën nr.7820, datë 6.8.2019 ju ka informuar se në kuadër të rishikimit të akteve normative për organizimin e programeve të studimit, me qëllim përmirësimin e përmbajtjes së tyre, lehtësimin e procedurave, dokumentacionit, do t'ju njoftojë mbi periudhën e aplikimit për hapjen /riorganizimin e programeve të studimit.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Oltjon MUZAKA

